

Përgatitur nga:



## ***RAST STUDIMOR***

**Ndikimet buxhetore të  
procesit të integrimit në BE  
në Ballkanin Perëndimor**

***Rasti i Republikës  
së Shqipërisë***



Ky rast studimor është përgatitur nga ekipi i **Impact Assessment Institute**:

**Erik Akse**

**Esmeralda Ballesha**

**Joana Naçi**

**Jona Jaha**

**Senem Safçi**

Dizajn nga:

**Spontan Creative Media**

***Të gjitha të drejtat e rezervuara.***

Ky rast studimor është produkt i ekipit të **Impact Assessment Institute**. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë rast studimi bazohen në diskutimet me palët e interesit dhe punën kërkimore të kryer nga ekipi ynë. Ju jeni të lirë të kopjoni, shpërndani, transmetoni dhe përshtatni këtë punë, përfshirë edhe për qëllime komerciale, duke cituar: **'Ky rast studimor është përgatitur nga Impact Assessment Institute'**.

## Infografika

Produktet që sjellin të ardhura më të larta për shkak të **importit të karburanteve** (rreth 47,853 milion lekë ose 400,6 milion euro), **cigareve** (rreth 28,323 milion lekë ose 237 milion euro) dhe **automjeteve të përdorura** për transport (rreth 7,008 milion lekë ose 58,6 milion euro), në total 83,184 milion lekë ose 696 milion euro.

Të ardhurat në milion lekë	Kontributi në % për doganat
Importet e karburanteve: 47,853 milion lekë ose 400,6 milion euro.	21.43 %
Importi i cigareve: 28,323 milion lekë ose 237 milion euro.	12.68 %
Mjete të përdorura për transport: 7,008 milion lekë ose 58.6 milion euro.	3.14 %
Totali: 83,184 milion lekë ose 696 milion euro.	37.25 % <i>(bazuar në të dhënat e marra nga Buletini Fiskal Janar-Dhjetor 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave)<sup>1</sup></i>

## Objektivat e politikës së BE-së:

**Marrëveshja e Gjelbër e Evropiane:** Lëndët djegëse fosile klimatike, kalimi në automjete me emetim zero.

**Plani i BE-së për të mposhtur kancerin:** Përpjekja për një shoqëri pa duhan.

## Humbja e parashikuar e të ardhurave deri në vitin 2040



### Karburanti

23,923 mil. ALL  
ose 200.3 mil. €  
50 % në 2040



### Cigaret

22,928 mil. ALL  
ose 192 mil. €  
81% në 2040



### Makinat

3,499 mil. ALL  
ose 29.3 mil. €  
50% në 2040

## Totali:


50,352 milion lekë ose 421.6 milion euro  
10% e të ardhurave buxhetore në 2040

## Rekomandime:

1. Zhvillimi i një strategjie afatgjatë të të ardhurave.
2. Zhvillimi i Planit të Investimeve për Integrimin Evropian: vlerësim gjithëpërfshirës i kërkesave dhe kostove të zbatimit që rezultojnë nga Integrimi Evropian.
3. Përfshirja e objektivave të BE-së në planifikimin financiar:
4. Krijimi i praktikës së vlerësimit të ndikimeve të politikave të BE-së ndërkohë që janë ende në zhvillim e sipër.
5. Forcimi i politikave që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike.

## Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Shqipëria është në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Rugëtimi i saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, kërkon angazhimin e saj për t'u përafuar me politikat dhe standardet e BE-së. Ky studim tregon ndikimin në të ardhurat doganore sa i takon importit të tre produkteve me të ardhura më të larta, përkatësisht lëndët djegëse fosile, cigaret dhe makinat, nëse përmbushen disa objektiva të politikës së BE-së nga Marrëveshja e Gjelbër e BE-së dhe Plani i BE-së për të mposhtur kancerin. **Studimi parashikon se vetëm për këto tre kategori produktesh, Shqipëria do të kishte një humbje vjetore të të ardhurave prej 50,352 milion lekë ose 421,6 milion euro, të barasvlershme me një reduktim prej 10% nga buxheti i vitit 2022.**<sup>3</sup> Kostot e parashikuara nuk përfshijnë humbjen shtesë të të ardhurave nga TVSH-ja nga këto produkte, duke lënë të kuptohet se ndikimi aktual mund të jetë më i lartë.



Ky ndikim i jashtëzakonshëm në të ardhurat e qeverisë do të thotë se duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme. Qeveria e Shqipërisë duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të ndikimeve të të ardhurave dhe kostove që rezultojnë nga procesi i integritit në BE. Ky vlerësim është vendimtar për financimin e reformave të rëndësishme të nevojshme në ekonomi, administratë dhe shoqëri për t'u përafuar me standardet evropiane. Qeveria gjithashtu duhet të zhvillojë kapacitetet për të përcaktuar ndikimet e politikave të BE-së ndërsa ato janë ende në zhvillim e sipër.

# **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>1</b>	Hyrje	<b>06</b>
<b>2</b>	Metodologjia	<b>08</b>
<b>3</b>	Gjetjet e Studimit	<b>10</b>
<b>3.1</b>	Marrëveshja e Gjellbër e BE-së për Energjinë	<b>11</b>
<b>3.2</b>	Marrëveshja e Gjellbër e BE-së mbi Lëvizshmërinë	<b>12</b>
<b>4</b>	Plani i BE-së për Mposhtjen E Kancerit	<b>13</b>
<b>4.1</b>	Prevalenca e duhanpirjes dhe sfidat rregullatore në Shqipëri	<b>14</b>
<b>5</b>	Konkluzione	<b>16</b>
<b>6</b>	Referenca	<b>18</b>


A large, light blue, stylized number '1' graphic that is partially cut off at the bottom left corner. It has a thick, blocky appearance with a slight shadow effect.

Hyrje

**K**y studim synon të vlerësojë ndikimet buxhetore afatmesme dhe afatgjata të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian (BE) në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Studimi fokusohet në një grup specifik të objektivave të politikës së BE-së për produktet që importohen dhe sigurojnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga doganat dhe akcizat. Konkretisht, ky studim fokusohet në implikimet e objektivave të politikës së BE-së në tre produktet me të ardhura më të larta, specifikisht karburantet, makinat dhe cigaret, në rastin e Shqipërisë.

BE-ja ka vendosur objektiva politikash specifike për këto produkte, ndërsa në Shqipëri, këto objektiva nevojitet të përfshihen në dokumente të ndryshme strategjike të nivelit kombëtar. Për të përmbyllur me sukses procesin e Integritimit Evropian, këto objektiva duhet të përfshihen plotësisht në hartimin e politikave kombëtare. Rezultatet e këtij studimi tregojnë implikimet e jashtëzakonshme buxhetore që synimet e politikave të BE-së mund të kenë në të ardhurat e qeverisë. Objektivat e politikës së BE-së vetëm për importet e karburanteve dhe cigareve, do të çonin në një ulje prej **10% të të ardhurave të qeverisë deri në vitin 2040**. Kërkohej veprime të menjëhershme për të siguruar që kjo humbje të ardhurash të kompensohet.

Nevoja për veprim bëhet dhe më e domosdoshme kur merren parasysh investimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e BE-së dhe për të zbatuar standardet e BE-së në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe ekonomisë. Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, digjitalizimi, reforma në sektorin bujqësor, Reforma e Administratës Publike dhe zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse që mbrojnë grupet e cenueshme, janë vetëm disa shembuj të politikave që kërkojnë angazhim dhe investim të konsiderueshëm nga qeveria.



**ULJE  
10%  
TË ARDHURAT  
E QEVERISË  
DERI NË  
2040**





**Metodologjia**




Ky studim bazohet në një metodë kërkimore cilësore e cila përfshin hulumtime të plota dhe intervista gjysmë të strukturuar/diskutime të hapura me aktorët kryesorë të qeverisë dhe shoqërisë civile që punojnë në fushat e politikave përkatëse të këtij studimi.

Hulumtimi u bazua në një analizë të objektivave të politikës për tre produktet me të ardhura më të larta, që janë karburantet, makinat dhe cigaret. Objektivat e politikave të BE-së u vlerësuan përmes analizës së Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së dhe Planit të BE-së për të mposhtur kancerin, pasi këto politika ndikojnë ndjeshëm jo vetëm në vendet anëtare të BE-së, por edhe në vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE në mënyrë indirekte.

Analiza u pasua nga diskutime të hapura me palët e interesit të qeverisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri. Në këto diskutime u përfshinë përfaqësues nga institucione të ndryshme publike si: Drejtoresha e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit Evropian nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zyrtarë nga Ministria e Financave, dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Tiranë, Shqipëri. Gjithashtu, diskutimet përfshinë edhe Drejtoreshën e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Politikave të Shëndetit Publik nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të

Transportit Rrugor dhe grupin e tij të punës. Pjesë e diskutimit ishin edhe Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri (AmCham) dhe Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri. Këto dialoge me institucionet çuan në informacione më të thelluara për këtë rast studimi.



**3**  
Gjetjet e Studimit



### 3.1 - Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Energjinë

Marrëveshja e Gjelbër e BE-së përcakton objektiva të ndryshme politikash në fusha të tilla si klima, energjia, transporti dhe taksat me synimin për të reduktuar emetimet neto të gazeve serrë me 55% deri në vitin 2030.<sup>4</sup> Për më tepër, ajo synon të reduktojë në zero emetimet neto të gazrave serrë deri në vitin 2050.

Si pjesë e politikës për uljen e emetimeve neto të gazrave serrë, vendet e BE-së në kuadër të kësaj Marrëveshje, ranë dakord gjithashtu të hartojnë legjislacion më të fortë për të rritur kapacitetet për energjinë e rinovueshme. Ky objektivi është vendosur si një minimum prej 42.5% deri në vitin 2030, pra një rritje prej 32% nga situata aktuale, me një ambicie për të arritur në 45%.<sup>5</sup> Për më tepër, objektivi i efikasitetit të energjisë për BE-në është vendosur 11.7% deri në 2030. Për të përmbushur këtë objektivi, vendet anëtare të BE-së duhet të bëjnë kursime vjetore prej mesatarisht 1.49% nga 2024 deri në 2030.<sup>6</sup>

## 3.2 - Marrëveshja e Gjelbër e BE-së mbi Lëvizshmërinë

Marrëveshja e Gjelbër e BE-së ofron gjithashtu objektiva specifike të politikave për lëvizshmërinë, duke synuar arritjen e një lëvizshmërie më të gjelbër përmes zgjidhjeve të një transporti të pastër, të arritshëm dhe të përbalueshëm. Bazuar në këtë fushë të politikës, të gjitha makinat dhe furgonët e rinj të regjistruar në BE do të kenë emetim zero deri në vitin 2035.<sup>7</sup> Një objektiv afatmesëm për të arritur emetimet zero përcakton që emetimet mesatare të makinave të reja të jenë më pak në 55% deri në vitin 2030 dhe për furgonët e rinj në 50% deri në vitin 2030.<sup>8</sup> Kjo do ta çojë transportin rrugor drejt përmirësimit të qëndrueshëm me emetim zero në vitin 2050.


Përveç reduktimit të emetimeve të CO<sub>2</sub>, objektivat e politikave për lëvizshmërinë ofrojnë gjithashtu

fusha përmirësimi edhe sa i takon nxitjes së përdorimit të transportit të pastër nga qytetarët e BE-së. Një nga këto fusha është krijimi i infrastrukturës së dedikuar për karikimin e automjeteve me emetim zero. Këto objektiva udhëzojnë zbatimin e infrastrukturës së karikimit elektrik dhe karburantit me hidrogjen në të gjitha territoret e BE-së. Kapaciteti i karikimit duhet të plotësojë kërkesat e një flote më të madhe automjesh me emetim zero. Për më tepër, objektivi i politikës së BE-së e bën gjithashtu të detyrueshëm futjen e çmimit të karbonit deri në vitin 2027, ku transporti rrugor do të mbulohet nga tregtia e emetimeve, duke vendosur një çmim mbi ndotjen, duke stimuluar përdorimin më të pastër të karburantit dhe duke ri-investuar në teknologji të pastra.<sup>9</sup>





Plani i BE-së për  
mposhtjen e kancerit



Plani i BE-së për mposhtjen e kancerit përcakton objektiva specifike politikash për të reduktuar përdorimin, shitjen dhe reklamimin e duhanit. Bazuar në këtë plan, BE-ja synon të krijojë një Shoqëri Pa Duhan, ku më pak se 5% e popullsisë të përdorë duhan deri në vitin 2040, krahasuar me rreth 25% në situatën aktuale.<sup>10</sup> Qëllimi i përkohshëm i BE-së është të arrijë objektivin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për një ulje prej 30% deri në vitin 2025, që korrespondon me një ulje të prevalencës të duhanpirjes prej rreth 20%.

Ky plan i referohet specifikisht Direktivës për Produktet e Duhanit dhe Direktivës për Tatimin e Duhanit. Këto dy direktiva përdoren si instrumente efektive për të luftuar konsumin e duhanit në BE. Direktiva për Produktet e Duhanit, e miratuar fillimisht në vitin 2014, aktualisht është vendosur të përditësohet për t'u përafuar me tregun e brendshëm të BE-së<sup>11</sup> Përveç kësaj, Direktiva për Tatimin e Duhanit përcakton një taksë për të ulur konsumin e duhanit. Në nivel të BE-së, objektivi kërkon që shtetet anëtare të vendosin një normë minimale të akcizës për cigaret.<sup>12</sup>

## 4.1 Prevalenca e duhanpirjes dhe sfidat rregullatore në Republikën e Shqipërisë

Një studim krahasues tregon se konsumi midis grave dhe burrave në mënyrë përmblendhëse zbulon një prevalencë të duhanpirjes prej 26.2% në vitin 2022.<sup>13</sup> Këto të dhëna janë marrë nga Raporti i Institutit të Statistikave (Instat).<sup>14</sup>

# Të ardhurat doganore: Pasqyra e ndikimit

	Fusha e Politikave	Objektivi i politikës së BE-së	Të ardhurat e tanishme doganore në Shqipëri	Të ardhurat e pritshme doganore në Shqipëri
<b>Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Energjinë</b>	Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë	55% deri në vitin 2030 0 deri në vitin 2050	Të ardhura nga importi i karburanteve në vitin 2022 47,853 milion lekë ose 400.6 mil. euro	50% reduktim në 2040: -23,923 milion lekë ose 200.3 milion euro  100% ulje në 2050: -47,853 milion lekë ose 400.6 milion euro
<b>Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Lëvizshmërinë</b>	Reduktimi i emetimit të CO2	Ulje me 55% e emetimeve nga makinat deri në vitin 2030  Ulje me 50% e emetimeve nga furgonët deri në vitin 2023  0 emetime nga makinat e reja në 2035	Të ardhurat nga të gjitha makinat në 2022: 7,008 milion lekë ose 58.6 milion euro <sup>16</sup>	Ulje me 50% deri në vitin 2040: -3,499 milion lekë ose 29.3 milion euro
<b>Plani i BE-së për të mposhtur kancerin</b>	Reduktimi i përdorimit të duhanit	Më pak se 5% në vitin 2040	Të ardhurat nga importi i cigareve në vitin 2022 28,323 milion lekë ose 237 milion euro <sup>17</sup>	Ulje me 81% deri në vitin 2040: -22,928 milion lekë ose 192 milion euro.
<b>Humbja totale e parashikuar e të ardhurave sipas skenarit të mos ndryshimit të politikës deri në vitin 2040</b>			<b>50,352 milion lekë ose 421.6 milion euro</b>	



5  
Konkluzione



Ka implikime të rëndësishme buxhetore afatmesme të politikave dhe objektivave të politikave të BE-së mbi të ardhurat e doganave në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht mbi humbjet e të ardhurave nga importi i karburantit si naftës, importet e makinave dhe importet e cigareve. Nëse nuk ka ndryshim politikash, humbja totale e të ardhurave nga doganat pritet të jetë 50,352 milion lekë ose 421.6 milion euro. Kjo shumë është e barabartë me 10% të të ardhurave të qeverisë shqiptare bazuar në buxhetin e vitit 2022.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se ka një thirrje urgjente për veprim të menjëhershëm. Qeveria duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë të procesit të integritimit në BE në të ardhurat, në mënyrë që të jetë në gjendje të trajtojë sfidën e mungesës së parashikuar në të ardhurat doganore. Kjo duhet të përfshijë qartësisht efektet e politikave të reja të BE-së ndërsa ato janë duke u zhvilluar. Duke kuptuar plotësisht ndikimin e pritshëm, qeveria mund të hartojë dhe zbatojë masa për të kundërshtuar çdo mungesë të mundshme në të ardhurat doganore dhe të ardhurat nga burime të tjera.

Përveç kësaj, qeveria duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të investimeve të nevojshme për zbatimin me sukses të Acquis të BE-së, veçanërisht duke u fokusuar në politikat që kanë kostot më të larta. Kjo përmbledhje gjithëpërfshirëse shërben edhe si një mjet për të siguruar që të

ardhurat dhe kërkesa për investime në të ardhmen të jenë në një linjë. Duke i vlerësuar këto aspekte, qeveria mund të garantojë që burimet financiare të akorduara të përputhen me kërkesat e procesit të integritimit në BE.

Për të pasur në konsideratë një fokus të qartë në ndikimet e Integritimit Evropian, qeveria duhet të ndërtojë kapacitete të fuqishme të dedikuara në përcaktimin e ndikimeve të politikave të BE-së ndërkohë që këto janë ende në zhvillim e sipër. Kjo qasje nënkupton angazhimin dhe bashkëpunimin aktiv me institucionet e BE-së, duke i vënë një theks të veçantë nxitjes së partneriteteve me Komisionin Evropian. Kjo qasje proaktive do t'i mundësojë qeverisë së Shqipërisë të harmonizojë strategjitë e saj në mënyrë më efektive, duke siguruar një proces më të suksesshëm integritimi dhe duke lehtësuar vendimmarrjen e informuar. Kjo mund të kombinohet më së miri me një vlerësim gjithëpërfshirës të kërkesave të zbatimit dhe kostove përkatëse që rezultojnë nga kërkesat e transpozimit të Acquis të BE-së dhe për të arritur standardet e BE-së në praktikë.

E fundit, dhe pa dyshim jo më pak e rëndësishme, me rritjen e nevojës për investime për financimin e procesit të Integritimit Evropian, qeveria duhet të forcojë të gjitha politikat e saj që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike. Kjo rritje do të jetë një faktor i rëndësishëm për të kompensuar humbjet në të ardhura dhe për të mbuluar nevojat për investime gjatë integritimit në BE.



Referenca

### **Faqe 3**

<sup>1</sup>Buletini Fiskal Janar-Dhjetor 2022  
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:  
<https://www.dogana.gov.al/dokument/4527/012buletini-fiskal-janar-dhjetor-2022>

<sup>2</sup>Projektligji për buxhetin për vitin 2024, tregon të hyrat faktike për vitin 2022  
<https://financa.gov.al/projektbuxheti-2024/>

### **Faqe 4**

<sup>3</sup>Projektligji për buxhetin e vitit 2024, tregon të hyrat faktike për vitin 2022  
<https://financa.gov.al/projektbuxheti-2024/>

### **Faqe 11**

<sup>4</sup>Marrëveshja e Gjelbër e BE-së - marrë nga:  
[https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en)

<sup>5,6</sup>Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, Energjia e Rinovueshme - marrë nga:  
[https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en)

### **Faqe 12**

<sup>7,8,9</sup>Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, Lëvizshmëria e Gjelbër - marrë nga:  
[https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en)

### **Faqe 14**

<sup>10</sup>Plani i BE-së për mposhtjen e kancerit - marrë nga:  
[https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:8dec84ce-66df-11eb-aeb5-01aa75ed71a1.0002.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:8dec84ce-66df-11eb-aeb5-01aa75ed71a1.0002.02/DOC_1&format=PDF)

<sup>11</sup>Direktiva për Produktet e Duhanit (2014/40/EU) – marrë nga:  
[https://health.ec.europa.eu/tobacco/product-regulation/implementing-tobacco-products-directive-directive-201440eu/revision-tobacco-products-directive\\_en](https://health.ec.europa.eu/tobacco/product-regulation/implementing-tobacco-products-directive-directive-201440eu/revision-tobacco-products-directive_en)

<sup>12</sup>Direktiva për Tatimin e Duhanit (2011/64/EU) – marrë nga  
<https://www.europarl.europa.eu/legislative-train/theme-an-economy-that-works-for-people/file-tobacco-directive-revision>

<sup>13,14</sup>Për duhanpirësit sipas grupmoshës 30-34 vjeç, konkretisht për meshkujt janë 45.1% dhe femrat 7.3%:  
<https://www.instat.gov.al/media/11027/burra-dhe-gra-2022.pdf>

### **Faqe 15**

<sup>15,16,17</sup><https://www.dogana.gov.al/dokument/4527/012buletini-fiskal-janar-dhjetor-2022>

